



Adresa: Bulevardi: "ZhanD'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. \_\_\_\_ Prot

Tiranë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ 2023

## **SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE**

Ne zbatim të nenit 26 të Ligjit nr.152/2013, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar si dhe të Kreut II dhe të III-të të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2015 "Për Plotësimin e Vendeve të Lira në Kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese", i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall procedurat e Lëvizjes Paralele, Ngritjes në Detyrë ose Pranim Në Shërbimin Civil për pozicionin:

### **1. Përgjegjës, i Sektorit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Kategoria e pagës III - 1)**

**PËR PROCEDURAT LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË !**

Pozicioni i mësipërm i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e Lëvizjes Paralele. Në përfundim të procedurës së Lëvizjes Paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, atëherë ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet Procedurës së Ngritjes në Detyrë. Vetëm në rast se edhe pas kësaj procedure pozicioni është vakant, atëherë ai është i vlefshëm për Pranim në Shërbimin Civil.

**Afati për aplikim për Lëvizje Paralele është dt. 25.09.2023**

**Afati për aplikim për Ngritje në Detyrë / Pranim në Shërbim Civil dt. 02. 10. 2023**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Përgjegjës, në Sektorin Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve.**

1. Përgjigjet për administrimin e burimeve njerëzore të institucionit;
2. Organizon, koordinon dhe mbikqyr zbatimin e procedurave ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me rekrutimin si dhe vlerësimin e rezultateve në punë;
3. Udhëzon, koordinon dhe mbikqyr zbatimin e procedurave ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me administrimin e dosjeve të personelit dhe të sistemit HRMIS;
4. Mban detyrën e Autoritetit Përgjegjës në Institucion për ILDKPI,
5. Prgatit kontratat e punës dhe ndjek afatet e tyre.
6. Organizon dhe mbikqyr procedura për hartimin e përshkrimeve të punës;

7. Administron të gjitha vlerësimet e punonjësve civilë si dhe bën vlerësimin e punonjësve të cilët ka në varësinë e tij;
8. Prgatit vendimet dhe ndjek afatet e konfirmimit të nëpunësve civilë.
9. Ndjek dhe evidenton marrjen e lejeve vjetore, raporteve mjeksore etj.
10. Ndjek dhe administron procesin e dhënies të masave disiplinore ndaj punonjësve.

## **I. LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm Nëpunësit Civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet, pjesë e Shërbimit Civil.

### **Kandidati për Lëvizjen Paralele duhet të plotësojë kushtet si më poshtë vijon:**

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument të lëshuar nga institucioni);
3. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë Mirë”

### **Kriteret e Veçanta**

- a) Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Shoqërore/ Shkenca Juridike/ Shkenca Ekonomike.
- b) Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në të njetjën fushë.
- c) Të ketë jo më pak se 5 (vite) vite eksperiencë në punë. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njehsuara paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- d) Të ketë aftësi menaxheriale dhe të zgjidhë problemet që ndikojnë në arritjen e rezultateve të Sektorit.
- e) Të ketë njohuri të gjuhës angleze, njohja e një gjuhe tjetër të vendeve të BE-së përbën avantazh.
- f) Të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup.
- g) Të ketë njohuri praktike në përdorimin e programeve të kompjuterit.
- h) Të jetë i aftë të raportojë në kohë për detyrat e ngarkuara

### **3. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) ose Zyrës së Protokollit të Institucionit të Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijon:

- Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail.
- Jetëshkrimin;
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor);  
Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- Fotokopje të Librezës së Punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të Letërnjoftimit (ID)

- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura ne jetëshkrimin tuaj.
- Vërtetim të Gjëndjes Shëndetësore;
- Vetëdeklarim të Gjëndjes Gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorine përkatëse.
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avoktit të Popullit brenda dates 25. 09. 2023**

#### **4.Rezultatet për Fazën e Verifikimit Paraprak**

Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve ( Sektori i Burimeve Njerëzore) në Institucionin e Avoktit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avoktit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Lëvizjes Paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të këtij pozicioni pune, renditen në një listë siapas rendit alfabetik.

Në të njëjtën kohë kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e Proçedurës së Lëvizjes Paralele të përcaktuara në shpallje për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet por administrohet nga Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektorit i Burimeve Njerëzore) i cili do të njoftojë në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektorit të Burimeve Njerëzore), brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

#### **Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista.**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

1. Njohuri mbi Ligjin nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
2. Njohuri mbi Ligjin nr.152/2013, “Për Nëpunësin civil”, i ndryshuar;
3. Njohuri mbi Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

4. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar;
5. Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.
6. Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit e miratuar me Urdhërin nr.129, datë 17.06.2022;
7. Njohuri mbi VKM nr.243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar;
8. Njohuri mbi VKM nr.242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, I ndryshuar;
9. Njohuri mbi VKM nr.108, datë 26.2.2014, “Për planin vjetortë pranimit në shërbimin civil”, i ndryshuar;
10. Njohuri mbi VKM nr.124, datë 17.02.2016, “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i vendosur ndryshuar;
11. Njohuri mbi VKM nr.125, datë 17.2.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”;
12. Njohuri mbi VKM nr.115, datë 5.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”;
13. Njohuri mbi VKM nr.117, datë 5.3.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrisë Qëndrore të Personeli”.

## **5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

- 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- 60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;

### **Vlerësimi i dokumentacionit**

Kandidatët do të vlerësohen për Jetëshkrimin, përvojën, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet positive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e punës, sipas fushës së njohurive;
  - Eksperiencat e tyre të mëparshme;
  - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

## **6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit të Avokatit të Popullit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334 ose në adresën: Avokati i Popullit, Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë.

## **II. NGRITJA NË DETYRË**

Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të Procedurës së Lëvizjes Paralele, rezulton se është ende vakant, atëherë ky pozicion është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet Procedurës së Ngritjes në Detyrë.

Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Për procedurën e Ngritjes në Detyrë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm Nënpunësit Civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një Institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për Ngritjen në Detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin vakant.

### **1. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Procedurën e Ngritjes në Detyrë janë:**

1. Të jetë Nënpunës Civil i konfirmuar në kategorinë ekzekutive;
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga Institucioni);
3. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë Mirë”.

### **2. Kriteret e Veçanta**

- a) Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Shoqërore/ Shkenca Juridike/ Shkenca Ekonomike.
- b) Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- c) Të ketë jo më pak se 5 (vite) vite eksperiencë në punë. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njehsuara paraprakisht pranë institucionit përgjigjës për njehsimin e diplomave sipas legjisllacionit në fuqi).
- d) Të ketë aftësi menaxheriale dhe të zgjidhë problemet që ndikojnë në arritjen e rezultateve të Sektorit.
- e) Të ketë njohuri të gjuhës angleze, njohja e një gjuhe tjetër të vendeve të BE-së përbënavantazh.
- f) Të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup.
- g) Të ketë njohuri praktike në përdorimin e programeve të kompjuterit.
- h) Të jetë i aftë të raportojë në kohë për detyrat e ngarkuara

## **1. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijon:

- Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë active e-mail.
- Jetëshkrimin;
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor);  
Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- Fotokopje të Librezës së Punes (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të Letërnjoftimit (ID)
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Vërtetim të Gjëndjes Shëndetësore;
- Vetëdeklarim të Gjëndjes Gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorine përkatëse.
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit brenda datës 02. 10. 2023**

### **Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokait të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Ngritjes në Detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë, kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyrer kërkimesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale nëpërmjet adresës së e-mailit, kandidatët që nuk janë kualifikuar. Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) brenda 5 ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi mere përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

## Fusha e njohutive dhe aftësitë mbi të cilat do të vlerësohen kandidatët

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

1. Njohuri mbi Ligjin nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
2. Njohuri mbi Ligjin nr.152/2013, “Për Nëpunësin civil”, i ndryshuar;
3. Njohuri mbi Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
4. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar;
5. Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.
6. Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit e miratuar me Urdhërin nr.129, datë 17.06.2022;
7. Njohuri mbi VKM nr.243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar;
8. Njohuri mbi VKM nr.242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar;
9. Njohuri mbi VKM nr.108, datë 26.2.2014, “Për planin vjetortë pranimit në shërbimin civil”, i ndryshuar;
10. Njohuri mbi VKM nr.124, datë 17.02.2016, “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i ndryshuar;
11. Njohuri mbi VKM nr.125, datë 17.2.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”;
12. Njohuri mbi VKM nr.115, datë 5.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”;
13. Njohuri mbi VKM nr.117, datë 5.3.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qëndror të Personeli”.

## 5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Jetëshkrimi që konsiston në vlerësimin e arsimit, përvojës e të trajnimeve të lidhura me fushën deri në 20 pikë
- Vlerësimi me shkrim sipas fushës së njohurive deri në 40 pikë
- Intervista e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar, i gjeni në udhëzimin Nr.2 dt.27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-datë-27-03-2015>

Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerzore), do të shpallë fituesin në portalin e “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)) dhe në këndin e njoftimeve të publikut të institucionit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042/380-346 ose në adresën: Avokati i Popullit, Bulevardi Zhan D'Ark, Nr.2, Tiranë

### **III. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL**

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së Pranimi në Shërbimin Civil.

#### **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil dhe kriteret e veçanta**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të Shërbimit Civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

- a) Të jetë shtetas Shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

#### **Kandidati duhet të plotësojë kriteret e veçanta si vijon:**

- a) Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Shoqërore/Shkenca Juridike/ Shkenca Ekonomike.
- b) Edhe diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në të njetën fushë.
- c) Të ketë jo më pak se 5 (vite) vite eksperiencë në punë. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njehsuara paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- d) Të ketë aftësi menaxheriale dhe të zgjidhë problemet që ndikojnë në arritjen e rezultateve të Sektorit.
- e) Të ketë njohuri të gjuhës angleze, njohja e një gjuhe tjetër të vendeve të BE-së përbënavantazh.
- f) Të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup.
- g) Të ketë njohuri praktike në përdorimin e programeve të kompjuterit.
- h) Të jetë i aftë të raportojë në kohë për detyrat e ngarkuara



**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit brenda datës 02. 10. 2023**

**Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokait të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Ngritjes në Detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë, kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyrer këtrkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale nëpërmjet adresës së e-mailit, kandidatët që nuk janë kualifikuar. Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) brenda 5 ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi mere përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike ng data e përfundimit të afatit të ankimit.

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit brenda datës 02. 10. 2023**

**Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokait të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Ngritjes në Detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë, kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyrer këtrkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale nëpërmjet adresës së e-mailit, kandidatët që nuk janë kualifikuar. Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) brenda 5 ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi mere përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike ng data e përfundimit të afatit të ankimit.

## 6. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Jetëshkrimi që konsiston në vlerësimin e arsimit, përvojës e të trajnimeve të lidhura me fushën deri në 20 pikë
- Vlerësimi me shkrim sipas fushës së njohurive deri në 40 pikë
- Intervista e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar, i gjeni në udhëzimin Nr.2 dt.27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-datë-27-03-2015>

Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerzore), do të shpallë fituesin në portalin e “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)) dhe në këndin e njoftimeve të publikut të institucionit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042/380-346 ose në adresën: Avokati i Popullit, Bulevardi Zhan D’Ark, Nr.2, Tiranë